

Nr.Regj.45284/2012

GJKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PPËRGJITHSHËM –DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Mehmet Nazmi Sopjani nga fshati Harilaq, kom. e Fushë Kosovës, për kundërvajtje nga neni 17, paragrafi 1.5 lidhur me nenin 15.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë, e në bazë të nenit 10, 73, 74 dhe 199 Ligjit mbi Kundërvajtjet, më datë 02.09.2013 merr këtë

AKTVENDIM

I PANDEHURI Mehmet Nazmi Sopjani, i lindur me 03.12.1962 në fshatin Harilaq, kom. e Fushë Kosovës, këshilltar komunal, kryer shkollën e mesme, i martuar, prind i katër fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa dënuar më parë për kundërvajtje, nuk është nën hetime, me vendbanim në fshatin Harilaq, kom. e Fushë Kosovës.

Është Përgjegjës

Sepse në afatin e paraparë ligjor, prej 15 ditësh, pas njohtimit nga ana e Agjencionit Kundër Korrupsionit, nuk e ka plotësuar formularin 13 që ka qenë i obliguar.

Me qka ka kryer kundërvajtje e sanksionuar sipas nenit 17 paragrafi 1.1, lidhur me nenin 15.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë, nr.04/L-050, andaj për këtë e konform nenit 10 të Ligjit mbi kundërvajtjet i shqiptohet masa e denimit

Qortim

Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dërgohet të pandehurit dhe parashtruesit të kërkesës.

Arsyetim

Agjencia Kunder Korrupsionit, parashtrroi kërkesën me nr.01-3648/2012 të dt. 11.10.2012 për fillimin e procedurës së kundërvajtjes kundër të pandehurit Mehmet Nazmi Sopjani për kundërvajtjen e sanksionuar sipas nenit 17 paragrafi 1.5 e lidhur me neni 15 paragrafi 3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë, nr.04/L-050

Gjatë procedurës është marrë në pyetje i pandehuri i cili në mbrojtjen e paraqitur para kësaj gjykate i pranon të dhënat nga kërkesa se e ka bërë deklarin e pasurisë në afatin ligjor për nuk e ka plotësuar formularin e duhur, gjegjësisht Formularin nr.13 dhe se e ka plotësuar Formularin 14 se për gabimin e bërë është njoftuar me kohë nga zyrtarët e Agjencionit Kundër korrupsionit dhe është ftuar që në afat prej 15 ditësh të plotësoj formularin adekuat gjë që nuk e ka bërë për arsyen e vetme që e ka neglizhuar këtë qështje duke menduar se vitin tjetër do ta plotësoj formularin e duhur.

Në lidhje me vërtetimin e gjendjes faktike gjatë procedurës është marrë në pyetje përfaqësuesi i Agjencionit Agron Behrami i cili para kësaj gjykate me përgjegjësi deklaroi se i pandehuri në cilësinë e zyrtarit të lartë-këshilltar në Kuvendin Komunal në Fushë Kosovë, pasurinë e ka deklaruar me kohë por në formularin e gabuar, prandaj pasi që nga zyrtarët e Agjencionit është konstatuar kjo qështje, i njëjti është njoftuar për gabimin prandaj është dhënë afati prej 15 ditësh që ta përmirsoj gabimin e bërë dhe të plotësoj Formularin nr.13, atë të duhurin, sepse në këtë formular deklarohet pasuri ndërsa në formularin 14 jepen të dhëna mbi ndryshimin e gjendjes së pasurisë por i pandehuri nuk e ka bërë përmirsimin e gabimit dhe se për këtë arsye është iniciu procedura kundërvajtëse ndaj tij.


Pas shqyrtimit të të dhenave në kërkesë, shqyrtimit të shkresave të lende, deklaratës së të pandehurit, përfaqësuesit të Agjencionit kundër Korrupsionit dhe provave tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtarja fitoi bindjen e lirë se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e sanksionuar sipas nenit 17 paragrafi 1.5 e lidhur me neni 15 paragrafi 3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë, nr.04/L-050 sepse në afatin e paraparë ligjor, prej 15 ditësh, pas njohtimit nga ana e Agjencionit Kundër Korrupsionit, nuk e ka plotësuar formularin 13 që ka qenë i obliguar, prandaj duke pas parasysh tëra rrehanat rënduese dhe lehtësuese nën të cilat është kryer kundërvajtje se me kundërvajtjen e tillë nuk janë shkaktuar pasoja të rëndë për shoqërinë, se i pandehuri jeton në kushte të vështira ekonomike, se nuk është i punësuar, andaj konform nenit 10 të Ligjit mbi kundërvajtjet, i shqiptoi masën e denimit QORTIM duke pas parasysh se edhe me këtë masë denimi tek i pandehuri do të arrihet efekti pozitiv i sanksionit dhe se në të ardhmen nuk do të kryej kundërvajtje të tillë apo të ngjajshme.

Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, ankesë mund të parashtrorë parashtruesi i kërkesës në afatin prej 8 ditësh, pasi që të njohtohet me kopjen e këtij Aktvendimi. Gjykatës së Apelit-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni i kundërvajtjes, përmes kësaj Gjykate dhe pa pulla.

VENDOSI GJKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI I KUNDËRVAJTJES

Gjyqtarja
Salihë Barisha Alimetaj



REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr Prot.
Dep. DPK/DMP	Br Prot.
Dep.	Prot No. 03-2701/13
Nr. I faq.	Data
Broj stranica	Datum
Nr. pages 01	Date 06-09-2013
PRISHTINE	